

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Projekti "Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies të qeverive të Ballkanit Perëndimor nëpërmjet zhvillimit të komunikimeve efektive strategjike"

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Ambasadën Britanike vazhdon zbatimin e projektit "Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies të qeverive të Ballkanit Perëndimor nëpërmjet zhvillimit të komunikimeve efektive strategjike - *Improving the openness and accountability of the governments of the Western Balkans through the development of effective strategic communications*".

Projekti ka si qëllim administrimin më efikas të komunikimeve strategjike të autoriteteve publike, sidomos, në forcimin e rolit dhe kapaciteteve të koordinatorit për të drejtën e informimit. Në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit është hartuar një paketë udhëzimesh orientuese për koordinatorët e të drejtës për informim duke përfshirë tema si: roli i koordinatorit për të drejtën e informimit; marrja e një kërkesë për informacion; përgjigja ndaj kërkesave për informacion dhe interesi publik dhe kufizimet e së drejtës së informimit.

Paketa e udhëzimeve është publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit në faqen www.idp.al - për autoritetin publik.

Ky është një projekt 3- vjeçar i cili ka nisur gjatë muajit korrik 2021 dhe zbatohet nga Shërbimi i Komunikimeve të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.



Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË NJË NGA SHTYLLAT
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit gusht 2022, ka dhënë 1 vendim urdhërimi për vënien në dispozicion të informacionit në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI).

Me anë të vendimit nr. 23 datë 03.08.2022, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Bankës së Shqipërisë", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Kërkuesi ka kërkuar informacion mbi "datën e fillimit të restaurimit të ish - hotel Dajtit; Sa është parashikuar zgjatja e punimeve fillimisht? Kur mbarojnë punimet? A janë vonuar punimet? Nëse janë vonuar, cilat janë arsyet? Sa kompani kanë marrë pjesë në garë, cilat janë ofertat? Emrat e kompanive që kanë fituar tenderin për të gjitha fazat, që nga projektimi e deri te zbatimi dhe mbyllja e tij".

Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke cituar se: "...Informacionet publike të kërkuara mund t'i gjeni në njoftimin për shtyp, të publikuar nga Banka e Shqipërisë, në faqen e saj zyrtare të internetit, në sqarimin për publikun, datë 13.06.2017. Ndërkohë pjesa tjetër e informacionit të kërkuar është i një natyre sensitive dhe të dhënat në përmbajtjen e tij janë informacion jo - publik, i klasifikuar".

Pas përgjigjes së sipërcituar, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24, të LDI.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se argumenti i paraqitur nga Autoriteti Publik për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, se informacioni i kërkuar është i një natyre sensitive dhe të dhënat në përmbajtje të tij janë informacion jo publik, i klasifikuar, nuk qëndron.

Gjatë procesit të hetimit administrativ të ankesës, Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion

të dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo zotërohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6, të nenit 17, të këtij ligji, ku përcaktohet se: "Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".

Nga praktikat e administruara nga Komisioneri, konstatohet se qëndrimi refuzues është i përsëritur nga Autoriteti Publik edhe pse Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme, vendimmarrje të cilat kanë mbetur në fuqi edhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përfundimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vendosi urdhërimin e autoritetit publik për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Për tu njohur me vendimin e plotë të Zyrës së Komisionerit klikoni në faqen zyrtare www.idp.al

Depozitohen instrumentet e ratifikimit të dy Konventave pranë Këshillit të Evropës



Albania ratified

- ▶ the Convention on access to official documents
- ▶ the Convention 108+ on data protection

@CoE_HRightsRLaw
www.coe.int/tromso-convention www.coe.int/dataprotection

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Shqipëria depoziton instrumentet e ratifikimit në Këshillin e Evropës për modernizimin e Konventës “Për mbrojtjen e individëve nga procedimi automatik i të dhënave personale” (Protokolli CETS No. 223, njohur si Konventa 108+) dhe Konventën 205 “Mbi aksesin në dokumente zyrtare”.

Konventat 108+ dhe 205 të KiE janë akte të rëndësishme për forcimin e demokracisë, shtetit ligjor dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Konventa 108+ është pjesë e legjislacionit shqiptar me miratimin nga Kuvendi, në 12 maj 2022, të ligjit nr. 49/2022. Ndërsa, Konventa 205 është bërë pjesë e legjislacionit shqiptar me miratimin nga Kuvendi, në 28 prill 2022, të ligjit nr. 45/2022.

ACCESS TO OFFICIAL DOCUMENTS

Convention 108 +
Convention for the protection of individuals with regard to the processing of personal data

▶ Council of Europe Convention on access to official documents (CETS No. 205) Tromsø 18.06.2009


www.coe.int/dataprotection

KOMISIONI I PËR TË DREJTËT E Mbrojtjes së individëve nga procedimi automatik i të dhënave personale

Deklarata "Qasja në informacion si një moment historik i epokës digjitale për të garantuar të drejtat e njeriut, përfshirjen e grupeve në situata të cenueshmërisë dhe forcimin e institucioneve demokratike në shekullin 21"

Në datën 24 qershor 2022 përfundoi Konferenca e 13-të Ndërkombëtare e Komisionerëve për të Drejtën e Informimit. Në përfundim të Konferencës, autoritetet anëtare miratuan deklaratën e titulluar "Qasja në informacion si një moment historik i epokës digjitale për të garantuar të drejtat e njeriut, përfshirjen e grupeve në situata të cenueshmërisë dhe forcimin e institucioneve demokratike në shekullin 21"

Kjo deklaratë gjendet e publikuar në faqen zyrtare të Konferencës Ndërkombëtare - në gjuhët anglisht, frëngjisht dhe spanjisht.



Autoritetet anëtare të Konferencës Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit angazhohen ndër të tjera të inkurajojnë institucionet ndërkombëtare, qeveritë kombëtare dhe organet e tjera publike për të zhvilluar në mënyrë proaktive sistemet e transparencës duke përfituar nga ecuria e teknologjive të informacionit, për të inkurajuar akses më të mirë në informacion nga qytetarët, me dispozita të veçanta të vendosura aty ku është e nevojshme për të pambrojturit

Deklarata e plotë mund të gjendet e publikuar në lidhjen <https://www.informationcommissioners.org/13th-icic-public-statement/>